



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A. Nr. 327/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Arben Mehmeti dhe Arditë Haxhnikaj Demi - anëtarë, dhe Rushit Kajtazi -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A. Nr. 327/2023 të datës 07.02.2023, të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Ministria e Financave, Punës dhe Transfeve, në çështjen juridike " kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 13.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.327/2023 të datës 07.02.2023, të parashtruar nga ankuesja
- II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

A r s y e t i m

Ankuesja ka qenë kandidatë në konkursin e shpallur nga Ministria e Financave e Punës dhe Transfereve të datës 14.11.2022 për pozitën "Receptionist/e" me numër reference 01/2022/DSHP/MFPT , e cila për shkak të mos përzgjedhjes si kandidatë fituese për këtë pozitë me datën 07.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1500/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me parregullsitë e zhvillimit të proceduarës së rekrutimit gjegjësisht të konkursit në fjalë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën e datës 07.02.2023 me numër protokolli 1500/2023 e

parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Memorandum mirëkuptimi i datës 21.10.2022; Letër Rekomandimi i datës 04.07.2022; Konkursi i datës 14.11.2022; e -maili i datës 07.02.2023; Lista e kandidatëve për intervistë me gojë e datës 23.12.2022; Lista e kandidatëve për intervistë me gojë e datës 28.12.2022; dëshmi foto; Id card e ankueses Aplikacioni për punësim; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 13.02.2023, me numër protokoli 1715/2023.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoje se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga* *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pasi ka pranuar përgjigje në ankesë me numër protokoli 2346 të datës 06.03.2023 nga Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, dhe në bazë të shqyrtimit të lëndës, respektivisht procedurën e rekrutimit për konkursin me numër reference 01/2022/DSHP/MFPT të datës 14.11.2022 të shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për pozitën "Receptionist/e", ka konstatuar se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve këtë procedurë të rekrutimit për konkursin e lartë përmendur e ka shpallur duke u bazuar në nenin 79 dhe 80 të Ligjit nr.06/144 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren nr.05/2022 për procedurat konkurruese dhe pranim për nëpunësit administrativ dhe mbështetës.

Me dispozitat e Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht me nenin 2 është përcaktuar se; "...2.Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës.... 6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike". Ndërsa me nenin 82 po të këtij ligji është përcaktuar se " Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në nenet 79 deri 81 të këtij ligji, marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës" rrjedhimisht, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në konkursin me numër reference 01/2022/DSHP/MFPT të datës 14.11.2022, të zhvilluar nga Ministria e Financave e Punës dhe Transfereve, Kolegji i Këshillit konstatoi në rastin konkret pozita "Receptionist/e" në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve është kategorizuar si nëpunës administrativo-teknik dhe mbështetës.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenit 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, thekson se nëpunësi administrativo-teknik dhe mbështetës fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të filloj kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetues së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, sepse Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil



Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar, se nuk është kompetent për shqyrtimin e kësaj ankese të datës 07.02.2023, pasi që ankuesja nuk e ka statusin e kandidates për punësim në shërbimin civil sepse procedura e rekrutimit për konkursin me numër reference 01/2022/DSHP/MFPT për pozitën "Receptionist/e" e shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Trasnfereve nuk ka qenë e shpallur për kategoritë e të punësuarve në shërbimin civil të përcaktuar sipas nenit 33 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr. 327/2023 të datës 07.02.2023, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesja nuk ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses, udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.*

Andaj pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

*Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr.327/2023*

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Malsore GASHI - BAJRAKTARI,

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të përgjithshëm në Ministrinë e Financave e Punës dhe Transefereve;
- Udhëheqësit të personelit në Ministrinë e Financave e Punës dhe Transefereve;
- Arkivit të KPMSHCK-së.